



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:065404

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697483

KPPP.nr.2109/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: 1. "Naki Trade" Sh.P.K., me NUI:71028437, me seli në Prishtinë, Rr."Agim Ramadani" pn dhe 2. M.V. me adresë në Prishtinë Rr."Nuhi Berisha" nr.6, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.617/22 të datës 19.07.2022, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorve 1. "Naki Trade" Sh.P.K., me NUI:71028437, me seli në Prishtinë, dhe 2. M.V. me adresë në Prishtinë, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.617/22 i datës 19.07.2022, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.617/22 të datës 19.07.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të urdhresës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatorë për kundërvajtje Nr.21/001237 të datës 25.09.2019, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguajë kreditorit shumën prej 500.00 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, si dhe me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitorët në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e kanë kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se debitori nuk e ka pranuar urdhëresën për pagesën e gjobës mandatarë për kundërvajtje në mënyrë që të bëjë pagesën komfor dispozitive të nenit 30, paragrafi 3 të Ligjit për procedurën për kundërvajtje, kreditori pa i dhënë mundësinë e tillë ligjore ka iniciuar procedurën përmbartimore ku tani përveç borxhit kryesor duhet të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore. Ka shtuar se propozimi dhe urdhri për përmbartim me urdhëresën për ndëshkim me gjobë mandatarë për kundërvajtje është në kundërshtim me par.1.3 të nenit 40 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të pranoj prapësimin si të bazuar dhe të anulohet procedura përmbartimore.

Kreditore, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se në bazë të fakteve të paraqitura në kundërshtimin e debitorit shihet qartë se asnjëra prej tyre nuk paraqet bazë për kundërshtim konform dispozitive të LPP-së. Ka shtuar se lidhur me pretendimet e debitorit se janë plotësuar kushtet për të goditur urdhrin përmbartimor, kreditore e njofton gjykatën se organet përmbartuese për inicim të procedurave përmbartimore janë të përcaktuara me LPP prandaj referimi i rasteve tek përmbartuesi privat është bërë në përputhje të plotë me LPP-në dhe Ligjin për kundërvajtje. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të vërtetohet urdhri për përmbartim, si dhe të obligohet debitori që të përmbush obligimin sipas këtij urdhri së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore deri në përfundim të kësaj çështje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitive të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohej në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbartimit, Urdhëresë për Ndëshkim me Gjobë Mandatore për Kundërvajtje Nr. 21/001237, i datës 25.05.2022, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbartimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 i cili përcakton "*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton*

përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti Urdhëresë për Ndëshkim me Gjobë Mandatore për Kundërvajtje Nr.21/001237, i datës 25.05.2022, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin, nuk përmban tiparet e një vendimi të organit administrativ, i cili mund të këtë cilësinë e dokumentit përmbarrues sipas nenit 23 par. 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse akt pajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.”*

Gjykata vlerësoi urdhrin për përmbarrim duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 4 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Përmbarruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarrueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarrueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.”* dhe gjeti se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim, për shkak se dokumentit mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbarrimit i mungon përshtatshmëria për ekzekutim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilës përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura përmbarrimore lidhur me këtë çështje, duhet të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2109/22, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.